



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**  
**Seksioni i Veçantë**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr. Prot.**  
**Nr. Dok. 201701519/12**

**Tiranë** \_\_\_/\_\_\_/2018

**Lënda:** *Rekomandohet transferimi i të dënuarve M. Th., B. Sh., M. M., P. Nj., G. M. dhe K. M. në një IEVP më afër vendbanimit të familjes*

**Drejtuar:** **Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve**  
**Z. Arben ÇUKO**

**TIRANË**

*I nderuar Z. Çuko,*

Institucioni i Avokatit të Popullit kreu një hetim me iniciativë për vdekjen e të burgosurit F. K., i cili sipas mediave ishte vetvarur në IEVP Lezhë në paraditen e datës 21.11.2017. Në përfundim të hetimit arritëm në përfundimin se, personeli i IEVP Lezhë nuk kishte vlerësuar saktë rrezikun për vetvrasje që paraqiste i burgosuri F.K. dhe se organika nuk ishte e plotësuar me staf mjekësor dhe social. Për këtë rast kemi dërguar në DPBurgjeve dhe IEVP Lezhë disa rekomandime me shkresën Nr.K2/I34-6 Prot., datë 17.01.2018.

Një nga veprimet e domosdoshme hetimore që duheshin kryer për të kuptuar nëse kjo ngjarje mund të parandalohet ishte marrja e shpjegimeve nga të burgosurit shokë dhome me F. K. dhe nga të burgosurit që e kanë gjetur atë të vetvarur.

Të burgosurit M. Th.(një nga personat që e ka gjetur të vetvarur të ndjerin), B. Sh.(shok dhome me të ndjerin) dhe disa të burgosur të tjerë janë transferuar nga IEVP Lezhë në burgje të tjera për arsye se, duke përdorur si pretekst ngjarjen e vetvarjes së bashkëvuajtësit kanë nxitur veprime që vijnë në kundërshtim me rregullat e burgut. Në deklaratimet e tyre me shkrim, përveç dëshmisë së dhënë lidhur me ngjarjen, M. Th. dhe B. Sh. kanë pretenduar se transferimi nga IEVP Lezhë është kryer për të fshehur të vërtetën, neglizhencën e treguar nga stafit i IEVP Lezhë për rastin e F. K. Ata kanë pohuar se, me tu përhapur lajmi i vdekjes së Florianit, nuk kanë pranuar të futen në regjim bashkë me të burgosurit e Godinës nr.4 dhe nr. 5 por, ky qëndrim është mbajtur në shenjë respekti për F. dhe proteste për neglizhencën e treguar nga stafi i IEVP Lezhë për të parandaluar vetvarjen. Të

burgosurit e tjerë që janë transferuar për arsye që lidhen me ngjarjen e datës 21.11.2017 janë: M. M., P. Nj., G. M. dhe K. M. Këto të burgosur janë transferuar bazuar në informacionin e I EVP Lezhë.

Në informacionin e I EVP Lezhë dërguar DPBurgjeve me shkresën Nr. Extra Prot., datë 29.11.2017 thuhet se, të dënuarit e Godinës Nr.4 dhe Nr.5 që gjendeshin në sheshin e ajrimit nuk kanë pranuar të hynë në dhoma pasi kanë marrë lajmin e vdekjes së të dënuarit F. K. Të burgosurit e dy godinave janë nxitur në veprimet e tyre që bien ndesh me rregullat e I EVP-ës nga të dënuarit e lartpërmendur, të cilët kohët e fundit kishin humbur disa privilegje në përdorimin e sendeve të ndaluara, prodhimin e pijeve alkolike, mbajtjen e telefonave celular dhe qarkullimin e lëndëve narkotike. Për të ruajtur sigurinë në I EVP Lezhë është kërkuar dhe miratuar transferimi në I EVP të tjera i të burgosurve organizatorë.

I EVP Lezhë i është kërkuar të na dërgojë fotokopje të raport-shërbimeve dhe masave disiplinore që mund të jenë dhënë në vitin 2017 ndaj të burgosurve të transferuar. Referuar informacionit të marrë, të dënuarit M. M., P. D. dhe G. M. nuk kanë masë disiplinore; i dënuari B. Sh. ka një masë disiplinore në dt. 03.09.2017 për mos respektim të afateve të lejes shpërblyese; i dënuari M. Th. ka një masë disiplinore në dt. 22.07.2016 për konflikt me një bashkëvuajtës; i dënuari K. M. ka një masë disiplinore në dt. 17.11.2017 për ofendim të punonjësit të policisë dhe thyerje të xhamave të dritares së spitalit të institucionit. Të dënuarit M. Th. dhe K. M. kanë shfaqur gjithashtu probleme të shëndetit mendorë.

Pretendimi i I EVP Lezhë se, 6 të burgosurit e lartpërmendur kanë nxitur shkeljen e rregullave në institucion për arsye se kanë humbur disa privilegje nuk është i bazuar. Nga dokumentacioni që na u vu në dispozicion nuk rezulton që ndonjëri prej tyre të ketë marrë masë disiplinore apo të jetë proceduar për përdorim të sendeve të ndaluara, prodhimi të pijeve alkolike, mbajtje të telefonave celular dhe qarkullimin të lëndëve narkotike Legjislativi në fuqi parashikon transferimin e të burgosurve për arsye sigurie, kur atyre u rrezikohet jeta apo shëndeti por, I EVP Lezhë nuk ka shpjeguar nëse refuzimi i të burgosurve për tu futur në regjim ka qenë i qetë apo është shoqëruar me ndonjë veprim të dhunshëm, nëse ky qëndrim ka përfunduar në datën kur ka ndodhur ngjarja apo ka patur edhe episode të tjera në vazhdim dhe cili ka qenë roli i dënuarve të transferuar. Të dënuarit M. Th. dhe K. M. janë vlerësuar si persona me probleme të shëndetit mendor dhe transferimi i tyre në një I EVP larg vendbanimit të familjes mund të rëndojë gjëndjen e tyre shëndetësore veçanërisht të të dënuarit M. Th., i cili e ka gjetur të vetvarur bashkëvuajtësin. Ky i fundit do të duhej të kishte qenë nën vëmendjen e stafit social pas ngjarjes. Institucioni duhet të kishte përdorur ndërmjetësimin si mundësi e parë për zgjidhjen e konfliktit mes të dënuarve dhe personelit. Transferimi duhet të favorizojë mundësinë që i dënuari të kryejë dënimin pranë vendbanimit të familjes.

Për sa më lart, bazuar në Nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut”* si dhe në mbështetje të Nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* (me ndryshimet përkatëse) ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”*

## **JU REKOMANDOJMË:**

Transferimin e të dënuarve M. Th., B. Sh., M. M., P. Nj., G. M. dhe K. M. në një IEVP më afër vendbanimit të familjes

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi.

*Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,*

**K O M I S I O N E R I**

**Arben SHKËMBI**